

ADINGFLEKS

Hidroizolim me elasticitet të lartë në bazë akrilate.
Përgjigjet në EN 1504-2/2-2/2. (C).

Fusha e aplikimit:

Për hidroizolim të pjesëve nëntokësore të objekteve ndërtimore të ekspozuara në presion pozitiv hidrostatik si: sipërfaqe të jashtme të mureve dhe të dyshemeve në bodrumet, pishina, ballkone, pullaze të rrafshëta, nyje sanitare, kuzhina, vende për larje, mbrojtje e sipërfaqeve të brendshme dhe të jashtme të kullat për ftohje dhe ngjashëm.

Përgatitje e nënshtresës:

Adingfleks vendoset mbi sipërfaqe stabile, në nënshtresë betoni, suva çimentoje, gurrë, pllaka gips-kartoni dhe ngjashëm. Nënshtresa duhet të jetë e shëndoshë, e pastër, pa yndyrëra si dhe pa pluhur, pa vende të segreguara (çarje). Nëse nënshtresa ka vende të segreguara ose plasaritje, të njëjtat duhet të sanohen me Reparatur Mallter – F. ose stuko epokside Adingpoks – K. Lagështia e nënshtresës duhet të jetë max. 7%, ndërsa temperatura e nënshtresës gjatë vendosjes së materialit Adingfleks duhet të jetë prej + 5°C deri +35°C.

Karakteristika teknike:

Cilësi	Metodë	Vlerë e deklaruar
Dukje		Përzierje e ngjyrosur viskoze
Dendësi	EN ISO 2811-1	1,5 - 1,56 kg/dm ³
Materie të pa avullueshme	EN ISO 3251:2003	74 - 80 %
Absorbicion kapilar dhe depërtueshmëri ndaj ujit	EN 1602-3	$w \leq 0.1 \text{ kg/m}^2 \text{ h}^{1/2}$
Depërtueshmëri ndaj avullit	EN ISO 7783-1	Sd < 5m – Klasi I
Fortësi adezive me pull off test	EN 1542	$\geq 1,5 \text{ MPa}$

Cilësi:

- Përzierje një-komponentëshe pastoze
- Elasticitet i shkëlqyer
- UV-stabil
- Jo-toksik
- Bakteriologjikisht rezistues
- I thjeshtë për realizim
- Adezion i shkëlqyer për nënshtresën
- Ekonomik

Vendosje:

Për të fituar shtresë mbrojtëse, përzierja duhet të vendoset në trashësi të drejtë shtresë-thatë.

Materiali për shtresën e parë hullohet me shtimin deri 15% ujë dhe përzihet me mikser të ngadalshëm elektrik (150 – 300 rrot./min.) deri në homogjenizimin e plotë. Shtresa e parë e vendosur lihet të thahet për tu vendosur shtresa e dytë. Për vendosje të shtresës së dytë dhe të tretë, materiali mund të hullohet deri 8% me ujë/

Vendosja e materialit bëhet me furçë me gjerësi 120 mm – 200 mm ose me cilindra me lesh në dy ose tre shtresa ose me spërkatje në më tepër shtresa (shtypja 300 bar), spërkatës me pipëz nr. 6,45-8,45 dhe vendosje në largësi prej 20-30 cm në mënyrë normale në nënshtresën e cila izolohet. Çdo shtresë e re vendoset mbi shtresë paraprake tërësisht të tharë. Distanca kohore midis vendosjes së shtresave duhet të jetë 6-24 orë varësisht nga temperatura.

Sipërfaqet e punuara duhet të jenë të mbrojtura nga të reshura, shkujë e fortë dhe ngrirje në periudhën prej minimum 48 orë. Temperatura gjatë vendosjes së hidroizolimit duhet të jetë 10°C deri 30°C.

Në rast të nënshtresës në të cilën priten deformime më të mëdha dhe paraqitje e plasaritjeve, për shkak të përforcimit – bërjes me armaturë rekomandohet që Adingfleks të vendoset në kombinim me rrjetëz nga fija joalkalike qelqi (45 gr/m). Rrjetëza shtypet me gletvegël në shtresën e parë menjëherë pas vendosjes. Me shtresën e dytë dhe të tretë rrafshohet-mbushet trashësia e rrjetit, me çka fitohet sipërfaqe monolite e hidroizolimit.

Pastrimi:

Veglat dhe pajisja, menjëherë pas përdorimit pastrohen me ujë.

Shpenzimi:

Për tre shtresa 1,2 deri 1,5 kg/m²
Kur izolimi përfordohet me rrjetëze
Për tre shtresa 1,8 deri 2 kg/m²

Paketimi:

Kanaçe teneqeje: 4 dhe 20 kg.

Vendosja në depo:

Në ambalazh të mbyllur origjinal. Në hapësira të thata, në temperaturë prej 5°C deri 30°C, i mbrojtur nga ekspozimi i drejtpërdrejtë ndaj diellit. Afati i përdorimit 12 muaj.

Rrezik për jetën: Nevojitet që të shmanget kontakti i prodhimit me lëkurën (të përdoren doreza mbrojtëse). Materiali nuk është toksik, por gjatë kontaktit incidental, në tast të kontaminimit të pjesëve të lëkurës, vendet e njëjta duhet menjëherë të lahen me ujë dhe sapun. Nëse materiali spërkat në sy, nevojitet që ato menjëherë të shpëlahen me shumë ujë dhe të kërkohet ndihmë mjekësore.

Zjarr: Adingfleks nuk mund të ndizet.

Pastrimi dhe vendosja në depo: Ambalazhi i vjetër i përdorur duhet të deponohet sipas dispozitave dhe rregullativave lokale për atë lloj të mbetjeve. Rekomandojmë që mënyra e vendosjes dhe sasia e nevojshme të përshtatet në kushtet e objektit, si dhe me përdorim të domosdoshëm të pajisjes përkatëse.